FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 36

Tiranë – E mërkurë, 9 mars 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 126, datë 2.3.2022	Për miratimin e modelit të uniformave ushtarake, gradave, simboleve, stemave e flamujve dekorativë të strukturave dhe shenjave të tjera dalluese të uniformës ushtarake, që mbajnë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.....	4205

VENDIM
Nr. 126, datë 2.3.2022

PËR MIRATIMIN E MODELIT TË UNIFORMAVE USHTARAKE, GRADAVE, SIMBOLEVE, STEMAVE E FLAMUJVE DEKORATIVË TË STRUKTURAVE DHE SHENJAVE TË TJERA DALLUESE TË UNIFORMËS USHTARAKE, QË MBAJNË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "ë", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e modelit të uniformave ushtarake, gradave, simboleve, stemave e flamujve dekorativë të strukturave dhe shenjave të tjera dalluese të uniformës ushtarake, që mbajnë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas albumeve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Modelet e miratuara me këtë vendim aplikohen, si më poshtë vijon:

a) brenda vitit 2022, uniforma dimërore dhe verore ceremoniale e Orkestrës Frymore dhe e Truprojës së Nderit të Forcave të Armatosura, stemat dhe flamujt dekorativë të strukturave të Forcave të Armatosura;

b) brenda vitit 2025, uniforma e stërvitjes;

c) brenda vitit 2027, uniforma e ceremonialit dhe asaj të punës.

3. Vendimi nr. 694, datë 21.11.2018, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e modelit të uniformave ushtarake, gradave, simboleve, flamujve dhe shenjave të tjera dalluese të uniformës ushtarake, që mbajnë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ALBUMI I STEMAVE, FLAMUJVE DEKORATIV, SHENJAVE KRAHËSE, SPECIALITETEVE, AFTËSIVE TË VEÇANTA DHE KURSEVE INSTITUCIONALE

STEMA E MINISTRISË SË MBROJTJES (MM)

Në një shqyt me sfond të bardhë dhe e kufizuar nga jashtë me një gërshet të artë janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "MINISTRIA E MBROJTJES" në pjesën e poshtme. Në të dy krahët është vendosur nga një degë ulliri. Në qendër është një shqyt me sfond të kuq, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë, e cila mban në secilën kthetër një shpat të artë. Në krye të shqiponjës është vendosur përkrenarja e Skënderbeut e artë në profil.

- Ngjyra e kuqe e shqytës simbolizon ngjyrën e flamurit kombëtar.
- Shqiponja me dy koka në qendër të shqytës është simboli kombëtar i flamurit.
- Dy shpatat në këmbët e shqiponjës simbolizojnë mbrojtjen e tërësisë territoriale të vendit.
- Dy degët e ullirit të vendosura në krahë janë simboli i paqes dhe bashkëjetesës.
- Përkrenarja e Skënderbeut e vendosur në krye të shqiponjës është një element kombëtar, i cili simbolizon qëndresën e popullit tonë ndaj armiqve.
- Ngjyra e artë e përdorur në elementët e stemave përfaqëson simbolikën tradicionale të kësaj ngjyre:

    - Fuqinë dhe superioritetit,
    - Të mirën dhe përsosmërinë,
    - Diturinë dhe inteligjencën.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë - C:0 M:20 Y:80; K:20
Jeshile - C:100 M:80 Y:100 K:0

STEMA E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (FARSH)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "FORCAT E ARMATOSURA" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë të kuqe me përkrenaren e Skënderbeut në qendër në ngjyrë të artë.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë - C:0 M:20 Y:80; K:20

STEMA E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FORCAVE TË ARMATOSURA (SHPFA)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me tre ngjyra bojë qielli, të gjelbër e blu me simbolet e Forcës Ajrore, Forcës Tokësore dhe Forcës Detare.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Bojë qielli - R:64 G:200 B:244;
Jeshile - R:0 G:166 B:81;
Blu - R:12 G:77 B:162;

STEMA E FORCËS TOKËSORE (FT)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "FORCA TOKËSORE" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri me dy pushkë të kryqëzuara ngjyrë floriri, simbole të Forcës Tokësore.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E FORCËS DETARE (FD)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "FORCA DETARE" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë blu me simbolin e Forcës Detare (spirancë).

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Blu - R:12 G:77 B:162;

STEMA E FORCËS AJRORE (FAJ.)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "FORCA AJRORE" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë bojë qielli me simbolin e Forcës Ajrore (krahët e hapur për fluturim).

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Bojë qielli - R:64 G:200 B:244;

STEMA E KOMANDËS MBËSHTETËSE (KM)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "KOMANDA MBËSHTETËSE" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri me simbolin e Komandës Mbështetëse , çelësat – element i furnizimit, rrota – element i transportit, rrota e dhëmbëzuar (ingranazhi) – element i mirëmbajtjes, kurora e dafinës – simbolizon fitimtarin.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
E bardhë - R:255 G:255 B:255

AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA (AFA)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt e vogël me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri me simbolin e Akademisë së Forcave të Armatosura rrethi – element i orientimit taktik, penda – element i të shkruarit dhe mësuarit, kartat e mbledhura – element i hartave, shpata – element i përgatitjes luftarake, kurora e dafinës – simbolizon fitimtarin.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E PËRFAQËSIVE USHTARAKE JASHTË VENDIT

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIC OF ALBANIA" në krye dhe "ALBANIAN NATIONAL MILITARY REPRESENTATIVE" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me sfond dyngjyrësh jeshil në gjysmën e diagonales së sipërme dhe blu në gjysmën e diagonales së poshtme i kufizuar me bordurë-shirit me ngjyrë të artë nga jashtë. Shqyti dyngjyrësh kufizohet me dy vija me ngjyrat e zëzë nga brenda dhe e kuqe nga jashtë.

Në krye të gjysmës së sipërme të shqytit vendosur mbishkrimi "ALBANIA NMR" me ngjyrë të artë dhe në të majtë stema e SHAPE e kufizuar nga një bordurë të hijëzuar me ngjyrë të bardhë.
Në të djathtë të gjysmës së poshtëme së shqytit vendoset stema e Forcave të Armatosura me një bordurë të hijëzuar me ngjyrë e bardhë.

Shqyti kryesor dyngjyrësh ndahet me tre vija diagonale me ngjyrat e kuqe - e zezë - e kuqe (dy vija të kuqe nga jashtë dhe një e zezë nga brenda).

Në qendër të shqytit është vendosur stema e NATO-s, brenda një rrethi me ngjyrë të bardhë ku çdo cep i stemës së NATO-s është zgjatur me një vijë të shkëputur me ngjyrë të bardhë.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Blu –R:12 G:77 B:162
Jeshile – R:0 G:166 B:81
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E INSITUTIT TË GJEOGRAFISË DHE INFRASTRUKTURËS USHTARAKE (IGJIU)

Dy rrathë me mbishkrimet në gjuhën shqipe dhe atë angleze "INSTITUTI GJEOGRAFIK DHE INFRASTRUKTURËS USHTARAKE" dhe "MILITARY GEOGRAPHIC AND INFRASTRUCTURE INSTITUTE" me një glob në mes i cili tregon detaje të formave tokësore dhe sipërfaqeve ujore, si dhe rrjetin e linjave të gjerësisë dhe gjatësisë gjeografike, detaje të cilat simbolizojnë ndërtimin e hartave.

KODI I NGJYRAVE

E bardhë - R:255 G:255 B:255;
Kafe druri - R:222 G:184 B:135
Bojë qielli - R:64 G:200 B:244;

STEMA E ARKIVIT QENDROR TË FORCAVE TË ARMATOSURA (AQFA)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "ARKIVI QENDROR I FA" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri me simbolin e AQFA, shqyta e vogël me ngjyrë të kuqe me bordurë të hollë ngjyrë të zezë simbolizon flamurin kombëtar; dosja dhe çelësi me ngjyrë të verdhë si element specifik i arkivave, simbolizojnë mirëadministrimin dhe sigurinë e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;
E verdhë - R:255 G:255 B:0

STEMA E QENDRËS KOMBËTARE TË KËRKIM SHPËTIMIT (QKKSH)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "QENDRA KOMBËTARE E KËRKIM SHPËTIMIT" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me tre ngjyrat e forcave kryesore të FA, bojë qielli, jeshile dhe blu. Në ngjyrë të artë janë simbolet të cilat përfaqësojnë operacionet "SAR" nëpërmjet ajrit, tokës dhe detit.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Bojë qielli - R:64 G:200 B:244;
Jeshile - R:0 G:166 B:81;
Blu - R:12 G:77 B:162;

STEMA E NJËSISË MJEKËSORE USHTARAKE E FORCAVE TË ARMATOSURA

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "NJËSIA MJEKËSORE USHTARAKE" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri me gjarprin - simbolin tradicional të shëndetësisë/mjekësisë, shpata – është simboli i mbrojtjes/luftës dhe me një shirit diagonal me ngjyrat e flamurit kombëtar.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E QENDRËS SË BASHKUAR OPERACIONALE TË FA (QBO)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe, janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "QENDRA E BASHKUAR OPERACIONALE" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri, ku janë të vendosura simbolet e forcave kryesore të FA dhe në krye briri që simbolizon thirrjen për kushtrim.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E QENDRËS SË MENAXHIMIT TË MATERIALEVE DHE LABORATORIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA (QMM & LFA)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe, janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "QMM & LFA" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri, në qendrën e të cilës ndodhet një simbol me pamjen e bletës ku janë kombinuar këto elementë: Imazhi i minës detare në krye, si element i menaxhimit qendror të A-M dhe mbikëqyrjes për zbatimin e standardeve të sigurisë gjatë demontimit dhe asgjësimit të armatim municionit. Anash janë dy zinxhirë që simbolizojnë menaxhimin e pashkëputur të zinxhirit logjistik nëpërmjet Programit të Automatizuar Logjistik, në pjesën e fundit të së cilit janë mikroskopit dhe eproveta të cilët janë simbole të laboratorit.Në pjesën e brendshme të krahëve është vendosur kompjuteri dhe pena, dhe poshtë tyre është simboli i strukturës logjistike që simbolizojnë automatizimin e materialeve logjistike. Në fund është simboli i atomit.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë ose C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E QENDRËS SË MENAXHIMIT TË MATERIALEVE (QMM)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe, janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "QENDRA E MENAXHIMIT TË MATERIALEVE" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri, në qendrën e të cilës ndodhet një simbol me pamjen e bletës ku janë kombinuar këto elementë: Imazhi i minës detare në krye, si element i menaxhimit qendror të A-M dhe mbikëqyrjes për zbatimin e standardeve të sigurisë gjatë demontimit dhe asgjësimit të armatim municionit. Anash janë dy zinxhirë që simbolizojnë menaxhimin e pashkëputur të zinxhirit logjistik nëpërmjet Programit të Automatizuar Logjistik, i cili nw pjeswn e brendshme të krahëve është vendosur kompjuteri dhe pena, dhe poshtë tyre është simboli i strukturës logjistike që simbolizojnë automatizimin e materialeve logjistike.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë OSE C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E LABORATORI I FORCAVE TË ARMATOSURA (LFA)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të vendosen mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "LABORATORI I FORCAVE TË ARMATOSURA" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri në qendër të së cilës është e vendosur simboli tradicional i trupave të kimisë, e rrethuar me simbolet e atomit, agjentëve biologjik, mikroskopit dhe eproveta të cilët janë simbole të laboratorit, kurora e dafinës – simbolizon fitimtarin.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe – C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë – C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë – R:255 G:255 B:255;
E artë - C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri – R:118 G:119 B:39;

STEMA E POLICISË USHTARAKE (PU)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "POLICIA USHTARAKE" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë blu me simbolin e Policisë Ushtarake shpatat e kryqëzuara – janë simbol tradicional i Policisë Ushtarake në të gjitha Forcat e Armatosura, inicialet "MP" të vendosura në një rreth – përfaqësojnë mbishkrimin "MILITARY POLICE", kurora e dafinës – simbolizon fitimtarin.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:2
Blu - R:12 G:77 B:162;

STEMA E BATALIONIT TË MBËSHTETJES SË SHPFA (BAT.MB.SHPFA)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "BATALIONI I MBËSHTETJES TË SHPFA" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me tre ngjyra bojë qielli, jeshile dhe blu, të cilat simbolizojnë Shtabin e Përgjithshëm të FA ku është vendosur simboli i Batalionit të Mbështetjes të SHPFA, "Shpata" – element tradicional i aktiviteteve ceremoniale, "Çelësi i Solit" – simbol tradicional i trupës muzikore, "Mburoja" – simbol tradicional i ruajtjes, "Rrota" – simbol tradicional i shërbimeve të transportit.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:2
Bojë qielli - R:64 G:200 B:244;
Jeshile - R:0 G:166 B:81;
Blu - R:12 G:77 B:162;

STEMA E AGJENCISË SË SISTEMEVE TË NDËRLIDHJES E INFORMACIONIT (ASNI)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "ASNI"(AGJENCIA E SISTEMEVE TË NDËRLIDHJES DHE INFORMACIONIT) në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri me simbolin e ASNI, flamujt, pishtari dhe antenat - element tradicional i trupave të ndërlidhjes, të cilat janë të rrethuara nga një kordon në ngjyrë ari, kurora e dafinës – simbolizon fitimtarin.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:22
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;
Blu - R:12 G:77 B:162;

STEMA E QENDRËS SË PERSONEL REKRUTIMIT (QPR)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri me një rreth me sfond blu (nuanca e ngjyrës së flamurit të NATO-s) me bordurë të jashtme dhe të brendshme ngjyrë ari. Pjesa qendrore e këtij rrethi ndahet në tre pjesë të barabarta dhe secila pjesë ka sfondin e forcave kryesore të Forcave të Armatosura.
Sfondi qendror do të jetë sfondi i Forcës Tokësore me ngjyrë të gjelbër me simbolin e saj (dy pushkë të kryqëzuara).
Në krahun e majtë do të jetë sfondi i Forcës Ajrore me ngjyrë bojë qielli me simbolin e saj (krahët e hapur për fluturim).
Në krahun e djathtë do të jetë sfondi Forcës Detare me ngjyrë blu me simbolin e saj (spiranca).
Në qendër të rrethit është vendosur një këmbane me ngjyrë ari, e cila simbolizon fillimin e procedurave për lajmërimin e rekrutimit të kandidatëve për oficerë, ushtar/detar aktivë në Forcat e Armatosura.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:2
Bojë qielli - R:64 G:200 B:244;
Jeshile - R:0 G:166 B:81;
Blu - R:12 G:77 B:162;

STEMA E BATALIONIT TË MBËSHTETJES ME SHËRBIME TË FT

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "BATALIONI I MBËSHTETJES ME SHËRBIME" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri ku janë vendosur simbolet që identifikojnë Batalionin e Mbështetjes me Shërbime (BMSH) të FT dhe simbolizojnë detyrat themelore të këtij batalioni.
Rrota simbolizon elementin e transportit, çelësi simbolizon elementin e administrimit dhe furnizimit, rrufeja simbolizon elementin e ndërlidhjes, gjarpri është simboli tradicional i shëndetësisë/mjekësisë, dy degët e ullirit simbolizojnë paqen dhe ushtari i armatosur simbolizon detyrën e ruajtjes.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:22
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E QENDRËS STËRVITORE TË FT

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "QENDRA STËRVITORE E FORCËS TOKËSORE" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqytë me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri me simbolin e Forcës Tokësore (dy pushkë të kryqëzuara ngjyrë floriri) me një libër, të cilat janë të rrethuara nga një kordon në ngjyrë ari, në të katër anët e të cilit janë pikat e horizontit për të simbolizuar orjentimin ne drejtimin e duhur.
Në krye janë gjashtë emblema për kurset që zvillohen në këtë qendër (Këmbësori, Zbulim, Artileri, Kimi, Komando dhe Forca Speciale). Në qendër është simboli i Forcës Tokësore dy pushkë të kryqëzuara dhe një libër, rrethi - element i orientimit taktik, libri - element i të mësuarit dhe të stërvitjes.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:22
Blu - R:12 G:77 B:162;
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E BATALIONIT TË PARË TË KËMBËSORISË TË FT

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe b1k (batalioni i parë i këmbësorisë) në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri në qendrën e të cilit ndodhet simboli i Forcës Tokësore (dy pushkë të kryqëzuara ngjyrë floriri). Në pjesën e sipërme të kryqëzimit të pushkëve është vendosur koka e ujkut në ngjyrë të bardhë me kurorë ngjyrë të zezë në pjesën e poshtme të qafës së ujkut. Në pjesët e tjera të kryqëzimit të pushkëve janë vendosur me ngjyrë të zezë: shkronja "b" në të majtë , shkronja "k" në të djathtë dhe numri "1" në pjesën e poshtme që tregojnë që është b1k.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:22
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;

STEMA E BATALIONIT TË DYTË TË KËMBËSORISË TË FT

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe b2k (batalioni i dytë i këmbësorisë) në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri në qendrën e të cilit ndodhet simboli i Forcës Tokësore (dy pushkë të kryqëzuara ngjyrë floriri). Në pjesën e sipërme të kryqëzimit të pushkëve është vendosur përkrenarja "Ilire" në ngjyrë gri të errët, poshtë të cilës kryqëzohen dy shpata "SIKA" me tehët në ngjyrë të bardhë dhe dorezat mbajtëse në ngjyrë kafe që simbolizojnë vazhdimësinë historike. Në pjesët e tjera të kryqëzimit të pushkëve janë vendosur me ngjyrë të zezë: shkronja "b" në të majtë , shkronja "k" në të djathtë dhe numri "2" në pjesën e poshtme që tregojnë që është b2k.

Kodi i ngjyrave

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:22
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;
Gri e errët - R:169 G:169 B:169;

STEMA E BATALIONIT TË TRETË TË KËMBËSORISË TË FT

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe b3k (batalioni i tretë i këmbësorisë) në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri në qendrën e të cilit ndodhet simboli i Forcës Tokësore (dy pushkë të kryqëzuara ngjyrë floriri). Në pjesën e sipërme të kryqëzimit të pushkëve është vendosur shqiponja me ngjyrë kafe të errët e cila simbolizon jetëgjatësinë, zgjuarsinë dhe trimërinë, poshtë të cilës ndodhet simboli i malit i cili përfaqëson malin e Shpiragut i cili ndodhet në rajonin ku është vendosur batalioni.
Në pjesët e tjera të kryqëzimit të pushkëve janë vendosur me ngjyrë të zezë: shkronja "b" në të majtë , shkronja "k" në të djathtë dhe numri "3" në pjesën e poshtme që tregojnë që është b3k.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:22
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;
Gri e errët - R:169 G:169 B:169;
Kafe - R:165 G:42 B:42

STEMA E REGJIMENTIT TË OPERACIONEVE SPECIALE (ROS) TË FT

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "REGJIMENTI I OPERACIONEVE SPECIALE" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri në qendrën e të cilit ndodhen, shpata si simboli më i vjetër luftarak i trimërisë dhe guximit, parashuta si simbol i infiltrimit nga ajri, aftësi të cilën duhet ta zotërojë çdo operator i Regjimentit, krahët e shqiponjës që simbolizojnë aftësinë për të operuar larg-në distancë edhe pas prapavijës së kundërshtarit dhe rrufetë si simbol i shpejtësisë, forcës goditëse dhe saktësisë.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:22
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;
Kafe - R:165 G:42 B:42
E bardhë - R:255 G:255 B:255;

STEMA E BATALIONIT KOMANDO TË ROS, FT

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "BATALIONI KOMANDO" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri në pjesën e sipërme është shkrimi "KOMANDO" në ngjyrë të verdhë dhe identifikon njësinë dhe në qendrën ndodhet thika simbol luftarak i komandove.

Kodi i ngjyrave

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:22
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;
Gri e errët - R:169 G:169 B:169
E verdhë - R:255 G:255 B:0;

STEMA E BATALIONIT TË FORCËS SPECIALE TË ROS, FT

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "BATALIONI I FORCËS SPECIALE" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri në qendrën e të cilës ndodhet simboli i Forcave Speciale; shpata- simboli më i vjetër luftarak, i trimërisë dhe guximit, parashuta - simbol i infiltrimit nga ajri, aftësi të cilën duhet ta zotërojë çdo operator i Regjimentit, krahët e shqiponjës - simbol i aftësisë për të operuar larg në distancë edhe pas prapavijës së kundërshtarit, rrufetë - simbol i shpejtësisë, forcës goditëse dhe saktësisë si pjesë përbërëse e Regjimentit.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:22
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E BATALIONIT TË MBËSHTETJES SË LUFTIMIT

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "BATALIONI I MBËSHTETJES SË LUFTIMIT" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqytë e vogël me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqytë e vogël me ngjyrë ulliri në qendrën e të cilës ndodhen tre simbolet që përfaqësojnë strukturat të cilat janë pjesë e Batalionit të Mbështetjes së Luftimit. Simboli i parë përfaqëson kompaninë e xhenios, simboli i dytë përfaqëson kompaninë e artilerisë dhe simboli i tretë përfaqëson kompaninë e kimisë. Të tre simbolet janë të vendosura në kurora dafine të cilat simbolizojnë fitimtarin dhe janë të gërshetuara me njëra tjetrën.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E QENDRËS STËRVITORE BAZË TË FD

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "QENDRA STËRVITORE BAZË E FD" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë blu në qendrën e të cilës ndodhen timoni i anijes me ngjyrë të verdhë dhe në qendër të tij ndodhet sekstanti me ngjyrë të zezë. Timoni është një nga elementët kryesorë në drejtimin e anijes. Ndërsa sekstanti është një ndër instrumentët kryesorë që përdoret në anije për përcaktimin e vendndohjes së anijes nëpërmjet pikave orientuese dhe yjeve.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20

STEMA E FLOTILJES DETARE PASHALIMAN

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "FLOTILJA DETARE PASHALIMAN" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë blu në qendrën e të cilës ndodhen një rreth i krijuar me cimën (litarin) e anijeve. Në brendësi të cimës ndodhet harta tokësore dhe detare e Shqipërisë. Harta detare simbolizon rajonin e përgjegjësisë së Flotiljes Detare nga derdhja e lumit Buna në veri deri në Kepin e Stilos në jug. Mbi hartë ndodhet trendafili i erërave që shërben për të gjetur drejtimin. Në fund të rrethit të brendshëm tre ngjyra, e kuqja, bluja dhe e gjelbërta që simbolizojnë tre flamujtë që përdoren në anijet e Flotiljes Detare (anijet luftarake, ndihmuese dhe të rojes bregdetare).

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Blu - R:12 G:77 B:162;
Bojë qielli - R:64 G:200 B:244;
Jeshile - R:0 G:166 B:81;

STEMA E QENDRËS SË VËZHGIMIT DETAR

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "QENDRA E VËZHGIMIT DETAR" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë blu në qendrën e të cilës ndodhet një rreth i krijuar me cimën e anijeve. Në brendësi të cimës ndodhet harta tokësore dhe detare e Shqipërisë. Harta detare simbolizon rajonin e përgjegjësisë së Qendrës së Vëzhgimit Detar nga derdhja e lumit Buna në veri deri në Kepin e Stilos në jug. Mbi hartë ndodhen disa rrathë që simbolizojnë mbulimin e radarëve të vendosura përgjatë bregdetit për të krijuar tablonë e detit.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Blu - R:12 G:77 B:162;
E verdhë - R:255 G:255 B:0;

STEMA E SHËRBIMIT HIDROGRAFIK

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "QENDRA E VËZHGIMIT DETAR" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë blu në qendrën e të cilës ndodhet një rreth i krijuar me cimën e anijeve. Në brendësi të cimës ndodhet harta tokësore dhe detare e Shqipërisë. Harta detare simbolizon rajonin e përgjegjësisë së Qendrës së Vëzhgimit Detar nga derdhja e lumit Buna në veri deri në Kepin e Stilos në jug. Mbi hartë ndodhen disa rrathë që simbolizojnë mbulimin e radarëve të vendosura përgjatë bregdetit për të krijuar tablonë e detit.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Blu - R:12 G:77 B:162;
E verdhë - R:255 G:255 B:0;

STEMA E QENDRËS SË ZHYTJES

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "QENDRA E ZHYTJES" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë blu në qendrën e të cilës ndodhet një rreth. Në brendësi të rrethit ndodhet një pamje deti me një anije në sfond si dhe skafandër zhytësi dhe një palombar. Skafandra është simbol i zhytësve të rëndë dhe palombari simbol i Qendrës së Zhytjes. Ndërmjet rrethit të brendshëm dhe rrethit të jashtëm, në pjesën blu ndodhet e shkruar QENDRA E ZHYTJES Pashaliman.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë ose C:0 M:20 Y:80; K:20
Blu - R:12 G:77 B:162;
Bojë qielli - R:64 G:200 B:244;
E verdhë - R:255 G:255 B:0;

STEMA E QENDRËS SË KONTROLL RAPORTIMIT TË F.AJ

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "QENDRA E KONTROLL-RAPORTIMIT " në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë bojë qielli në të cilën ndodhen një palë krahë të hapur dhe në qendër të tyre është një rreth ku janë vendosur disa rrathë të cilat simbolizojnë rrathët në ekranet e radarit. Në këtë rreth është vendosur gjithashtu dhe harta e RSH, një avion, si dhe ylli i veriut të cilët mbështillen nga një hark me ngjyrë të kuqe.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Bojë qielli - R:64 G:200 B:244;

STEMA E QENDRËS SË STËRVITJES TË F.AJ

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "QENDRA STËRVITORE E FORCËS AJRORE" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë bojë qielli në të cilën ndodhen një libër që simbolizon mësim dhënien dhe trainimin e personelit, elikat e avionit, ingranazhet dhe kulla e aerodromit të cilat janë simbole të trajnimit të pilotëve, trajnimit të mirëmbajtësve dhe trajnimit të kontrollorëve të trafikut ajror.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Bojë qielli - R:64 G:200 B:244;

STEMA E BAZËS AJRORE KUÇOVË

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "BAZA AJRORE KUÇOVË" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë bojë qielli në të cilën ndodhen një palë krahë të hapur, si simbol i forcës Ajrore mbi të cilat ndodhet simboli i NATO-s.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Bojë qielli - R:64 G:200 B:244;

STEMA E BAZËS AJRORE FARKË

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "BAZA AJRORE FARKË " në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë bojë qielli në të cilën ndodhen një palë krahë të hapur simbol i Forcës Ajrore, mbi të cilat ndodhet rrethi kuq e zi i cili është simboli i cili vendoset në mjetet fluturuese të Forcave tona Ajrore me siluetën e një helikopteri në qendër si simbole të kësaj baze ajrore.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Bojë qielli - R:64 G:200 B:244;

STEMA E SHËRBIMIT METOROLOGJIK USHTARAK

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "SHËRBIMI METEOROLOGJIK USHTARAK " në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë bojë qielli me simbolin e diellit, shiut, reve, borës dhe shkarkesave elektrike.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë - C:0 M:20 Y:80; K:20
Bojë qielli - R:64 G:200 B:244;
Gri e errët - R:169 G:169 B:169
E verdhë - R:255 G:255 B:0

STEMA E QENDRËS STËRVITORE TË KM

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "QENDRA STËRVITORE E KOMANDËS MBËSHTETËSE" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri me simbolin e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse libri i hapur – element i instruktorit, shpatat e kryqëzuara – element i përgatitjes luftarake, kurora e dafinës – simbolizon fitimtarin.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë - C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E BATALIONIT TË FURNIZIMIT

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "BATALIONI I FURNIZIMIT" në pjesën e poshtme.
Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë.
Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri me simbolin e batalionit të furnizimit simboli i çelësave te kryqëzuar – element i furnizimit, kurora e dafinës – simbolizon fitimtarin.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E BATALIONIT TË TRANSPORTIT

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "BATALIONI I TRANSPORTIT" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri me simbolin e batalionit të transportit rrota – element i transportit, kurora e dafinës – simbolizon fitimtarin.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë - C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E QENDRËS SË RIPARIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË TEKNIKËS SË FORCAVE TË ARMATOSURA

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "QENDRA E RIPARIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË TEKNIKËS SË FORCAVE TË ARMATOSURA " në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë.
Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri (ushtarake) me simbolin e QRMTFA-së simboli i rrotës së dhëmbëzuar (ingranazhi) – element i mirëmbajtjes, kurora e dafinës – simbolizon fitimtarin.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë - C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E BAZËS SË MBËSHTETJES DHE EMERGJENCAVE CIVILE (BMEC)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "BAZA E MBËSHTETJES DHE EMERGJENCAVE CIVILE". Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri (ushtarake) me simbolin e Bazës së Mbështetjes dhe Emergjencave Civile, kullat e kalasë dhe ura – element i infrastrukturës dhe mirëmbajtjes së saj, zjarri i kontrolluar – element i emergjencës civile, kurora e dafinës – simbolizon fitimtarin.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E BATALIONIT TË XHENIOS

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "BATALIONI I XHENIOS" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri me simbolin e Batalionit të Xhenios: ura, kalaja – element i ndërtimit te infrastrukturës dhe mirëmbajtjes së saj, predha si element EOD, kurora e dafinës – simbolizon fitimtarin.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E FAKULTETIT TË MBROJTJES DHE SIGURISË (FMS)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe, janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "FAKULTETI I MBROJTJES DHE SIGURISË" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës është vendosur simboli i FMS, mburoja – element që përfaqëson mbrojtjen, helmeta dhe shpata – elementë të prejardhjes ilire dhe të përgatitjes luftarake, libri dhe penda – elementë të të shkruarit dhe mësuarit.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C: 100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Jeshile - C: 100 M:80 Y:100 K:0

STEMA E INSTITUTIT TË KËRKIMIT SHKENCOR USHTARAK (IKSHU)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "INSITUTI I KËRKIMIT SHKENCOR USHTARAK" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri me një rreth me sfond të kaltër, ku është vendosur një libër, shkrimet përcaktojnë detyrat e IKSHU që përfaqëson dijen; ylli me shumë cepa që përfaqëson doktrinën. kurora e ullirit – simbolizon paqen.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë - C:0 M:20 Y:80; K:20
Bojë qielli - R:64 G:200 B:244;
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E QENDRËS SË ARSIMIMIT PROFESIONAL TË NËNOFICERËVE (QAPN)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "QENDRA E ARSIMIMIT PROFESIONAL TË NËNOFICERËVE" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një shqyt e vogël me ngjyrë ulliri me simbolin e QAPN, penda – element i të shkruarit dhe mësuarit, shpata – element i përgatitjes luftarake dhe libri element i të mësuarit.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

STEMA E QENDRËS SË ARSIMIMIT PROFESIONAL TË USHTARËVE (QAPU)

Në një shqyt me sfond të zi dhe e kufizuar nga jashtë me një bordurë të kuqe, janë vendosur mbishkrimet "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" në krye dhe "QENDRA E ARSIMIMIT PROFESIONAL TË USHTARËVE" në pjesën e poshtme. Në qendër është një shqyt me ngjyrë të kuqe, e cila ka shqiponjën me dy koka në ngjyrë të artë. Në qendër të shqiponjës ndodhet një simbol i përbashkët si shenjë e identifikimit të njësisë për dallimin nga njësitë dhe repartet e tjera të Forcave të Armatosura. Ajo është në formë shqyte me dimensione 6x7 cm, e ndarë në katër pjesë, nga të cilat dy me ngjyrë të kuqe dhe dy me ngjyrë të verdhë, të vendosura në pozicion diagonal. Kompozimi i shenjave në fushat respektive është specifik për Qendrën e Arsimimit Profesional të Ushtarëve dhe kanë këtë përmbajtje: tre shpatat simbolizojnë forcën; shenja e jeshile në formë "Λ" simbolizon rendimin luftarak; krahu i shqiponjës simbolizon krenarinë, pishtari simbolizon lajmërimin e fitores.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe - C:0 M:100 Y:100 K:0;
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
E verdhë - R:255 G:255 B:0;

FLAMURI DEKORATIV I FORCËS TOKËSORE

Flamuri kombëtar me shqiponjën me dy koka, ka në qendër një shqyt me ngjyrë ulliri me simbolin e FT.
Përmasat e flamurit janë 107x150 cm dhe rrethohet me një kordon dekorativ të artë.

KODI I NGJYRAVE
E kuqe – B:0 K:100 V:100 Z:0; (në bazë të Ligjit Nr. 8926, date 22.7.2002)
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
E artë C:0 M:20 Y:80; K:20
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;

FLAMURI DEKORATIV I FORCËS DETARE

Flamuri kombëtar me shqiponjën me dy koka, ka në qendër një shqyt me ngjyrë blu, me simbolin e FD.
Përmasat e flamurit janë 107x150 cm dhe rrethohet me një kordon dekorativ të artë.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe – B:0 K:100 V:100 Z:0; (në bazë të Ligjit Nr. 8926, date 22.7.2002)
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
Blu - R:12 G:77 B:162;
E artë - R:210 G:170 B:65;

FLAMURI DEKORATIV I FORCËS AJRORE



Flamuri kombëtar me shqiponjën me dy koka, ka në qendër një shqyt me ngjyrë bojë qielli, në të cilën është vendosur simboli i Forcës Ajrore.
Përmasat e flamurit janë 107x150 cm dhe rrethohet me një kordon dekorativ të artë.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe – B:0 K:100 V:100 Z:0; (në bazë të Ligjit Nr. 8926, date 22.7.2002)
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
Bojë qielli - R:64 G:200 B:244;
E artë - R:210 G:170 B:65;

FLAMURI DEKORATIV I KOMANDËS MBËSHTETËSE

Flamuri kombëtar me shqiponjën me dy koka, ka në qendër një shqyt me ngjyrë ulliri, në të cilën është vendosur simboli i Komandës Mbështetëse.
Përmasat e flamurit janë 107x150 cm dhe rrethohet me një kordon dekorativ të artë.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe – B:0 K:100 V:100 Z:0; (në bazë të Ligjit Nr. 8926, date 22.7.2002)
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;

FLAMURI DEKORATIV I AKADEMISË SË FORCAVE TË ARMATOSURA

Flamuri kombëtar me shqiponjën me dy koka, ka në qendër një shqyt me ngjyrë ulliri, në të cilën është vendosur simboli i Akademisë së Forcave të Armatosura. Përmasat e flamurit janë 107x150 cm dhe rrethohet me një kordon dekorativ të artë.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe – B:0 K:100 V:100 Z:0; (në bazë të Ligjit Nr. 8926, date 22.7.2002)
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;
E artë - R:210 G:170 B:65;

FLAMURI DEKORATIV I NJËSISË MJEKËSORE USHTARAKE TË FORCAVE TË ARMATOSURA

Flamuri kombëtar me shqiponjën me dy koka, ka në qendër një shqyt me ngjyrë ulliri, në të cilën është vendosur simboli i Njësisë Mjekësore Ushtarake të Forcave të Armatosura.
Përmasat e flamurit janë 107x150 cm dhe rrethohet me një kordon dekorativ të artë.

KODI I NGJYRAVE

E kuqe – B:0 K:100 V:100 Z:0; (në bazë të Ligjit Nr. 8926, date 22.7.2002)
E zezë - C:100 M:100 Y:100 K:100;
Ngjyrë ulliri - R:118 G:119 B:39;
E artë - R:210 G:170 B:65;
E bardhë - R:255 G:255 B:255;

FLAMURI DEKORATIV I POLICISË USHTARAKE

Rezistenca në forcë	kg		UNI EN ISO 13934-1
Rezistenca në tërheqje			UNIENISO13934-1
Trajtimet	**Kundra rrudhosjes, kundra njollave vajore ,e papershkrueshme nga uji UNI EN ISO12945-2**		
	Trajtim kundra pushëzimit dhe krijimit të kokrrizave (nearfishing- antipilling) UNI EN ISO12945-2		
QENDRUESHMERIA E NGJYRES	**Njesia e matjes**	**Vlera dhe Toleranca**	**Metoda e proves**
Degradimi ne drite artificiale		4-5	UNI EN ISO 105-B02
Djersa bazike		Degradimi 4-5	UNI EN ISO 105-E04
Djersa alkaline / acide		Degradimi 4-5	UNI EN ISO 105-E04
Larje e thate		4-5	UNI EN ISO 105-D01
Me uje		5	UNI EN ISO 105-E01
Ferkimi në të thatë		4-5	UNI EN ISO 105-X12
Ferkimi në të njomë		4-5	UNI EN ISO 105-X12
Me sperkatje uji		4-5	UNI EN ISO 105-E07
Me hekurosje		4	UNI EN ISO 105-X11

Përshkrim Model Pantallonat Ceremoniale Verore

Pantallonat të përbëhen prej:
Dy pjesësh të përparme pa xhepa dhe pa pensa, me bel të lartë prej një copë të vetme.
Dy pjesësh të prapme me xhep me fileto në krahun e djathtë, 1 fashetë qendrore dhe pjesa e belit e hapur në qendër të pantallonit në pjesën e prapme.
Pjesa fundore e prapme të jetë e përbërë prej pjesës së pulpës me qepje në qendër të gjurit në pjesën e prapme.
Pjesët e kofshëve të jenë të përbëra prej një kthine të sheshtë të mbyllur dhe të futura në pjesën e poshtme.
Në anësore të bashkohen nga qepja dhe nga një përforcim prej 6 mm.

Të mos ketë xhepa në anësore.
Beli i lartë rreth 8 cm nga brenda paraqet një forcim SILEAS i bardhë, 6 kopsa për llastikun. Në pjesën e prapme të ketë dy pensa të qepura rreth 13 cm tek të dyja pjesët.
Xhepi i pasëm me fileto të zezë të jetë rreth 13 cm dhe largohet rreth 14 cm nga pjesa e sipërme e pantallonave.
Fasheta simetrike dhe me bordurë të kuqe të jetë e larguar rreth 5,5 cm në pjesën e sipërme të belit dhe të jetë e pozicionuar në qendër të pjesës së prapme të pantallonave.
Pjesa e brendshme e përparme të ketë një përforcim RAYON i bardhë deri tek gjuri duke e përjashtuar atë.

Dizenjoja e pjesës së përparme të pantallonave

Pantallonat të paraqesin tek të dyja pjesët e përparme një motiv luleje me tre rrathë të mbyllur në një romb me tre cepa me borde në formë rrethi.

Dimensionet:
Boshti i brendshëm dopio të jetë me një gjatësi 26 cm dhe të përfundojë me tre rrathë DALLAE me diametër 3 cm dhe të larguar nga cepi i rombit rreth 3 cm.
Cepat e rombit për të tri anësoret të përfundojnë drejt pjesës së jashtme me një dizenjo prej rrethi me diametër 1 cm.
Rreth 20 cm nga beli (pjesa e sipërme) të nisi cepi i ketërt, nga këmba e lules që ndahet nga tubi dysh (6 mm).
Pantallonat të përfundojnë me një bordurë të zezë me copë SILESIAS dhe me një hapje anësore nga ana e jashtme rreth 8 cm të bashkuar nga një shirit VELCRO rreth 2 cm.
Tek pjesa e fundit të aplikohet një llastik i zi me dimensione 3 cm H dhe 26 cm L.
Për oficerët kordoni është ngjyrë e verdhë, për n/oficerët dhe ushtarët kordoni është ngjyrë e zezë.

UNIFORMA CEREMONIALE VERORE

KAPELJA ME STREHË

UNIFORMA E CEREMONIALE E TRUPROJES SË NDERIT: KAPELE ME STREHË

Përshkrim Model Kapele Ceremoniale me Strehë

Kapelja me strehë të përbëhet nga një palë anësore me një lartësi prej 10-12 cm dhe një tub i përforcuar me astracan sintetik. Pjesa e sipërme e kapeles (tavani) të jetë e përbërë nga një copë me ngjyrë të kuqe të errët, ngjyra e flamurit shqiptar të jetë e sheshtë dhe e rrethuar, e bashkuar në formë cilindri në mënyrë që të formohet një shkallë prej 8 mm. Pjesa e brendshme të jetë e përforcuar me një copë pambuku të zezë apo një përforcuese.
Në qendër të sheshit të kuq të kapelës do të qëndiset emblema e shqiponjës.

Qeleshja për oficerët ka në përbërje një gërshet me fill ari për zbukurim që nis nga qendra e kapur me një kopsë kalon në anësore e majtë poshtë dhe përfundon prapa në qendër lart dhe të jetë me një kupë të realizuar me fill ari.
Qeleshja për nënoficerët dhe ushtarët ka në përbërje një gërshet me fill të kuq që nis nga qendra e kapur me një kopsë kalon në anësore e majtë poshtë dhe përfundon prapa në qendër lart dhe të jetë me një kupë të realizuar me fill të kuq.

Streha e kapeles është material lëkure me shkëlqim me ngjyrë të zezë.

Kordoni në formë gërsheti të mbërthehet tek pjesa e përparme me një kopsë të verdhë dhe në pjesën e prapme nëpërmjet një kopse të brendshme qëndrore. Kupa së bashku me pjesën fundore të kapet nëpërmjet qepjes së kupolës (tavanit) të pasëm qendror. Në pamjen ballore aplikohet embelma. Emblema e kapelës është e vendosur në një fushë të rrumbullakët me ngjyrë të kuqe për oficerët ose të zezë për nënoficerët dhe ushtarët.
Masa nga 53 deri tek 60.
Lartësia Astracan të jetë për të gjitha masat njësoj rreth 10-12 cm.

QENDRUESHMERIA E NGJYRES	Njesia e matjes	Vlera dhe Toleranca	Metoda e proves
Degradimi ne drite artificiale		4-5	UNI EN ISO 105-B02
Djersa alkaline / acide		4	UNI EN ISO 105-E04
Ferkimi në të thatë		4	UNI EN ISO 105-X12
Ferkimi në të njomë		4	UNI EN ISO 105-X12
Me sperkatje uji		5	UNI EN ISO 105-E07
Larje e thate		4-5	UNI EN ISO 105-D01
Me uje		4-5	UNI EN ISO 105-E01

UNIFORMA CEREMONIALE VERORE

KËMISHË ME MËNGËTË GJATA

UNIFORMA CEREMONIALE: KËMISHA

Copa termoadesive për të gjithë rripin dhe pjesën e kyçit		SKEDA TEKNIKE E MATERIALIT KRYESOR	
Përbërja	Pambuk i mercerizuar i	Lënda e parë	100 % Pambuk i krehur puplin
Ngjyra	E Bardhë	Fijet	Duhet të jenë të rregullta dhe t'i korrespondojnë karakteristikave në përshkrim dhe përdredhjes së paraqitur në modelin përkatës
Titulli:	40/3	Zbardhja	Duhet të arrihet nëpërmjet sistemeve racionale në mënyrë që fibra e pambukut të mos qëndrojë e dëmtuar
Rezistenca dinamometrike :	Kg. 1.200	Copa	Duhet të jetë e rregullt dhe identike për nga pamja me modelin për këtë, pa defekte, me dizenjo uniformë, e tharë dhe e butë në mënyrë perfekte por jo e lëshuar, nuk duhet të ketë gjurmë klori
Gjatësia :	26mm	Dizajni	Duhet të rezultojnë uniforme, të rregullta dhe të shtrira mirë, me një lartësi jo më shumë se gjysmë centimetri
Maksimumi i shkurtimit në ujë	1%	Armatura	Pëlhurë
Humbja më e madhe në sparekiature :	1 %.	Lartësia	148-150 cm
Kopsat:	Të Bardha prej sedefi me 4 vrima	Pesha në m2:	110 gr
Diametri	Rreth 1 cm	Emërtimi i fillit:	INE 40/1
Të gjitha materialet e përdorura nuk duhet të jenë të dëmshme e toksike. Duhet të jenë të përshtatshme për përdorim gjatë qepjes dhe prerjes së punimit me dorë.			NE 40/1
		Numri i fijeve ne cm:	N.55
		Thurja	N.28
		Rezistenca dinamometrike	
		Thurja:	N.650 – 66,30kg
		Maja:	N.320 – 32,60 kg
		Shkurtimi gjatë larjes	1,5%
		Ngushtimi gjatë larjes	1,5%
		Zgjerimi maksimal i lejuar	1%

Përshkrim Model Këmisha me Mëngë të Gjata Dimërore, duhet të ketë këto specifikime teknike:

Këmisha përbëhet nga pëlhurë pambuku e bardhë dhe të përmbajë pjesët e mëposhtme:
• Trupi • Jaka • Rripi • Mëngët

Trupi

Trupi të jetë i përbërë nga tre pjesë : dy pjesët e përparme të bashkuara me të qepurat anësore të kthyera dhe pjesa e pasme e pajisur me shpatulloren.
Dy pjesët e përparme të jenë plotësisht të hapura dhe të kthyera nga përpara me një rrip duke kthyer anët nga brenda për rreth 3,5cm.
Në të djathtë të jenë vendosur 6 kopsa prej sedefi të larguara prej tyre me një distancë prej 8-10 cm (sipas masës së këmishës). Në të majtë në përputhje me kopsat të jenë vendosur 6 filiqe vertikale. Në dy anët e përparme të aplikohet nga brenda shtresë e forcuar – nga e njëjta pëlhure sipas modelit. Ajo të formohet nga qepje forcimi tek rripi në pjesën e përparme të shpatullës dhe tek mënga; tek pjesa e lirë të jetë e kthyer lehtas buza rreth 4 mm. Shpatullorja të jetë e formuar nga dy shtresa pëlhurë sipas modelit.
Masat e këmishës të jenë 10 duke filluar nga numri 37 deri tek numri 46.Modeli të jetë i njëjtë si për personelin mashkull ashtu edhe për atë femër.

Jaka

Jaka të jetë model polici dhe me ngjitje me material valkrof.

Rripi

Rripi të jetë i formuar nga dy shtresa pëlhure (njëra e brendshme dhe tjetra e jashtme). I brendshmi të jetë i përbërë nga nje copë, ndërsa i jashtmi të jetë plotësisht i ngjitur nëpërmjet proçesit të fuzionit me të nxehtë me një forcim të përbërë nga një shtresë cope të padeformueshme. Ai të jetë i lartë 35 mm dhe të ketë tre filiqe horizontale, ndër të cilat dy të jenë përpara (një në anë të djathtë dhe një në anë të majtë) dhe një nga pas në qendër.
Filiqja e anës së djathtë dhe ajo e pasme të aplikohen vetëm tek shtresa e jashtme dhe tek forcimi i rripit në mënyrë që të lejojë kalimin nëpërmjet një të çare prej 3 cm të kopsave për të kapjen e qafores së sertë.

Mengët

Mengët të jenë të formuara vetëm nga një copë me qepje makine të kthyera: të përfundojnë tek kyçi me një kopsë sedefi (me diametër 1 cm) dhe me filiqen përkatëse.
Pjesa e kyçit të jetë e krijuar sipas modelit dhe përbëhet nga dy shtresa pëlhure (një e brendshme dhe një e jashtme). Ajo e brendshmja të jetë e përbërë nga një copë e vetme, ndërsa e jashtmja të jetë tërësisht e ngjitur nëpërmjet proçesit të fuzionit më të nxehtë me një forcim të përbërë nga një shtresë cope të padeformueshme.
Në ekstremitetet e mëngëve të krijohet përgjatë pjesës së brrylit një e çarë rreth 11 cm; ajo kufizohet nga njëra anë me një rrip të radopiuar (të vendosur me dy shtresa) nga e njëjta copë, e gjerë 25 mm dhe e gjatë 155 mm; nga ana tjetër krijohet një palë rreth 4 mm.

Mbërthimi i mëngëve kryhet nëpermjet qepjeve të kthyera.

ARTIKUJ TË TJERË

ÇIZME

ÇIZMET CEREMONIALE

Çizme ceremoniale (lëkurë viçi) me ngjyrë kromi i zi përbëhen nga elementët dhe aksesorët e mëposhtëm:
• Shtresa e sipërme • Fundi • Aksesorët.
Realizohen në prerjet nr. 36 deri në nr. 48.
Pjesët e lëkurës, gomës dhe të gjithë aksesorët e tjerë të përshkruar duhet të plotësojnë kushtet e parashikuara si dhe të gjithë materialet e përdorura duhet të mos jenë të dëmshëm për shëndetin, (jo toksikë) dhe të jenë të përshtatshëm për tipin specifik të këpucës që do të përdoren.

SHTRESA E SIPËRME:
Shtresa e sipërme që përbëhet nga:
• Pjesa e sipërme. • Pjesët anësore. • Pjesa fundore e jashtme. • Veshja me lëkurë. • Përforcimet anësore të brendshme. • Thembra e brendshme. • Mbështetësja. • Nënmaja.

Pjesa e sipërme
Shtrihet në të gjithë pjesën e përparme të këpucës, deri në pjesën e qafës.

Materiali i siperm:	Lëkure (viç) e përbërë nga një pjesë të vetme, e nxjerrë nga pjesët më të mira të lëkurës së viçit
Ngjyra:	Kromi i zi
Trashësia e lëkurës (spesori):	0.8-1mm mm

Pjesët anësore
Në pjesën e jashtme të çizmeve është stampuar simboli kombëtar.

Materiali i siperm:	Te jetë prej lëkure (viçi) në dy pjesë pa defekte të lëkurës
Ngjyra	Kromi i zi
Trashësia e lëkurës (spesori):	0,5 – 1 mm.

Pjesa Fundore e Jashtme:

Materiali:	Të jetë prej lëkure viçi, e përbërë nga një pjesë të vetme e nxjerrë nga pjesët më të mira të lëkurës
Ngjyra	Kromi i zi
Trashësia e lëkurës (spesori):	0,8 – 1 mm.

Veshja e Brendshme e Lëkurës
Të jetë me lëkurë e hollë dhie, në dy pjesë, njëra të jetë në të njëjtën linjë me shtresën e sipërme, në përputhje më pjesët elastike anësore; trashësia e lëkurës (spesori) 0,5 – 0,8 mm. Të dy pjesët e veshjes të bashkohen ndërmjet tyre dhe me shtresën e sipërme. Përforcimet anësore të brendshme: me lëkurë dhie ose viçi e njëjtë me atë të përdorur për veshjen e brendshme dhe shtresën e sipërme, të hapura dhe lëmuara me një trashësi (spesor) 0,5 – 0,8 mm. Të vendosen ndërmjet shtresës së sipërme dhe veshjes së brendshme të lëkurës, në pjesën e nënmajës dhe mbështetëses.

Materiali:	Lëkurë e hollë dhie
Ngjyra:	E zezë
Trashesia:	0,5 – 0,8 mm

Pjesa e brendshme te thembra
Të jetë me të njëjtën lëkurë dhie si ajo e përdorur për veshjen e brendshme; trashësia e lëkurës (spesori) 0,6 – 1 mm. Të jetë e përbërë nga një pjesë e vetme me formë të lëmuar dhe e vendosur në pjesën e brendshme të çizmes afër takës.

Materiali:	Lëkurë dhie të njëjtën si ajo e përdorur për veshjen e brendshme. Të jetë e përbërë nga një pjesë e vetme me formë të lëmuar dhe e vendosur në pjesën e brendshme të çizmes afër takës
Trashesia:	0,6 – 1 mm

Nënmaja:

Materiali:	Lëkurë e përbërë nga një pjesë e vetme. Të vendoset në pjesën e përparme të këpucës ndërmjet veshjes së brendshme dhe të jashtme.
Trashesia:	1,3–1,8 mm

Fundi i çizmes
Fundi i çizmes përbëhet nga:
• Pjesa e poshtme e këmbës. • Thembra me lëkurë. • Pjesa anësore e qepjes ndërmjet shollës dhe pjesës së sipërme.
• Pjesa e poshtme prej gome. • Goma. • Taka.

Materiali:	Lëkurë e përbërë nga një pjesë e vetme, pa prerje ose defekte të tjera. Duhet të vishet me material të fortë të papërpunuar për pjesën e poshtme.
Trashësia e lëkurës (spesori):	2,5–3mm

Thembra me lëkurë: të jetë me material lëkure, e përbërë nga një pjesë e vetme më formën e versionit zyrtar, me prejardhje nga pjesët dytësore të lëkurës së kurrizit. Të vendoset në brendësi të pjesës së pasme të nënkëmbës për të mbuluar pjesët e paveshura. Të jetë e lëmuar në ekstremitet.

Pjesa anësore e qepjes ndërmjet shollës dhe pjesës së sipërme: Të përbëhet nga një pjesë lëkure që lidhet nëpërmjet makinerisë së këpucarit me pjesën e sipërme dhe me pjesën fundore. Dimensionet: trashësia e lëkurës (spesori) 3 mm + 10%, gjerësia 15mm + 0,5mm.

Pjesa e poshtme prej gome: Të bashkohet me takën si një pjesë e vetme, proporcionalisht si në gjatësi dhe gjerësi, të vendoset në pjesën fundore të këpucës ku mbështetet harku i shputës.

Goma; duhet të jetë pa defekte, me trashësi uniformë dhe e njëjtë për të dy shollat e së njëjtës palë çizmeje. Trashësia të jetë 4 – 4,5 mm. Duhet të ngjitet me pjesën qendrore. Forma duhet të jetë e thellë 1,5mm dhe duhet të jetë e izoluar përpara ngjitjes. Goma në pjesën e poshtme të takës duhet të fiksohet me thembrën e brendshme dhe pjesën e poshtme të këmbës me ngjitje 16 mm në mënyrë që të sigurojë lidhje e fortë të pjesëve..

Taka: Të përbëhet nga jo më shumë se 5 fletë nën takë dhe mbrojtëse take prej gome. Fletat e nëntakës janë prej gome, të mirëgoditura dhe cilindruara. Në pjesën që lidhet me këpucën duhet të ketë një boshllëk të formësuar më derdhje në mënyrë që të ngjitet në mënyrë përfekte më gomën. Forma e boshllëkut mund të bëhet dhe më një pjesë qepje me lëkurë të lëmuar dhe e vendosur në formë patkoi. Në këtë rast duhet të eliminohet një fletë në nëntakë. Fletët e jashtme të nëntakës duhet të vendosen në pjesën e mishit për të lejuar më shumë ngjitje në pjesën e mbrojtëses së takës në gomë. Taka duhet të ketë lartësinë, duke filluar nga pjesa fundore e thembrës prej 16-18 mm dhe 28 – 30 mm e matur nga pas.

AKSESORËT

Llastikët: duhet të përftohen nga nastro elastike, ngjyrë e zezë, te cilat montohen në pjesën vertikale mbrapa çizmes në paralel me gjithë gjatësinë e zinxhirit. Të përbëhen nga dy pjesë të aplikuara për çdo çizme. Ato mund të montohen me qepje në të dy anët e zinxhirit me qëllim që pjesa e sipërme e pulpës së këmbës të jetë fleksibël që t'i përshtatet diametrit të pulpës për çdo dimension, toleranca duhet të jetë 4-5cm.

Zinxhirët: duhet të jenë me ngjyrë të zezë me material plastik me formë spirale bllokuesi fundor duhet të jetë metalik. Gjithashtu edhe koka lëvizëse e zinxhirit duhet të jetë metalike me bllokues, në pjesën e sipërme të çizmes duhet të vendoset një mbyllje me një shirit me buton me sustë metalike. Shiriti duhet të ketë përbërje llastiku dhe lëkurë që të jetë fleksibël në dimension për një bllokim perfekt të kokës së zinxhirit

Penjtë: fijet për qepjen e pjesës së sipërme me pjesën fundore duhet të jenë poliester ose poliamid.

ARTIKUJ TË TJERË

ÇORAPET E GJATA

ARTIKUJ TË TJERË: ÇORAPE TË GJATA	
PËRBËRJA E MATERIALIT:	
Ngjyra	E zeze
60 %	Pambuk
35 %	Poliamid
5 %	Elastan
Gjatesia e çorapes poshte gjurit	

ARTIKUJ TË TJERË

DOREZAT CEREMONIALE PAMBUKU

ARTIKUJ TË TJERË: DOREZA CEREMONIALE PAMBUKU	
Përbërja	Dorezat të jenë të përbëra nga fibra pambuku, të punuara me fill dysh. Përbërja pambuk Tip "America I".
Modeli	Dorezat si model duhet t'i korrespondojnë modelit ushtarak dhe të përbëhen secila nga : • Pjesa e kyçit të dorës. • Pjesa kryesore (shpina e dorës dhe pëllëmba). • Pesë gishtërinjtë;. Gishti i madh të lidhet me trupin e dorezës nëpërmjet dy të qepurave paralele të distancuara njëra nga tjetra 2 mm. Gishtërinjtë duhet të jenë në proporcion; meqenëse dorezat duhet të jetë komode dhe estetike, majat e tyre duhet të jenë të rrumbullakosura. Ekstremiteti i lirë i kyçit të jetë i përthyer nga brenda dorezës. Kthimi të jetë i lartë rreth 20 mm dhe të ndalet nëpërmjet qepjes me makinë i shoqëruar nga një fill i fortë i kthyer në tre herë për lakun dhe prej mëndafshi natyral i kthyer dy herë për gjilpërën e qëndisjes. Nga ana e pëllëmbës, doreza të shfaqë duke nisur nga bordura e kyçit, një të çarë me një gjatësi prej 75mm, anët e të cilës janë të përthyera dhe të forcuara me një pjesë shiriti të bardhë pambuku, të lartë rreth 15 mm. 40 mm nga bordura e pulsit, e çara të fillojë të mbyllet me një kopsë të bardhë me përbërje sintetike, me mbështetje, me kokë rrumbullake me diametër 12 mm dhe që përputhet me syçkën. Në vend të llojit të kopsës së përshkruar me sipër mund të përdoret një kopsë e bardhë me përbërje sintetike, me katër vrima, me diametër të njëjtë. Syçka të jetë e forcuar nga brenda dorezës me një pjesë të vogël nga shiriti i bardhë i përshkruar me sipër me material , të bërë dysh (dopio). Pikat e mbërthimit të kopsës të jenë edhe ato të forcuara nga brenda me po ato pjesë nga shiriti i përshkruar më lart. Mbi shpinore, doreza të shfaqë tre qepje me reliev, divergjentë midis tyre, të cilat të fillojnë rreth 75 mm nga bordura e kyçit dhe të arrijnë deri aty ku fillon hapja e gishtërinjve; të tilla qepje të realizohen me pikë të gërshetuara, nëpërmjet një filli pambuku të bardhë, të cilësisë së lartë, të bërë tresh.
Qepja	Qepjet e tjera të dorezës duhet të kryhen me një fill të fortë pambuku të bërë tresh. Të gjitha qepjet duhet të rezultojnë rezistente dhe t'i korrespondojnë për nga lloji dhe rregullsia modelit ushtarak. Po ashtu, ato duhet të kenë fije që perfundojne te prera mirë: të bëhet përjashtim për tre qepjet me reliev, ekstremitetet e të cilave, drejt pulsit, duhet të jenë të lira, vetëm nëse dalin nga coha, në pjesen e brendshme të dorezës, me një gjatësi prej 10-20 mm. Dorezat duhet të kthehen mire nga ana e brendshme. Masat nga 6 – 9.
Ngjyra	E Bardhë

UNIFORMA VERORE

ORKESTRA FRYMORE
OFICERË, N/OFICERË, USHTARË

UNIFORMA VERORE

ORKESTRA FRYMORE
OFICERË, N/OFICERË, USHTARË

UNIFORMA CEREMONIALE

XHAKETA

UNIFORMA CEREMONIALE E TRUPROJES SË NDERIT: XHAKETA			
Xhaketë Ceremoniale VERORE			
Ngjyra	**E Kuqe pantone tpx 18-863**		
Karakteristikat Fiziko- Mekanike	**Njesia e matjes**	**Vlera dhe toleranca**	**Standardi**
Njesia e matjes	%		Panno 1/96 1/96
Vlera dhe toleranca			Tela uni 8099
Standardi	%	100% lesh MERINOS	
Gjeresia e Tekstilit	cm	148/150	
Pesha për mtl	gr	240/250	EN 12127 - EN 29073/1
Pesha për mtq	gr	160/170	EN 12127 - EN 29073/1
Dendësia e fijeve në thurjen në horizontal (bazë) për cm	copë	16	UNI EN 1049/2
Titulli i Fillit			1/9600
Rezistenca në forcë	kg		UNI EN ISO 13934-1
Rezistenca në tërheqje	%		UNI EN ISO 13934-1
Dendësia e fijeve në thurjen në vertical (ind) për cm	copë	12/13	UNI EN 1049/2
Titulli i Fillit			1/9600 UNI 9275 - ISO 7211/5
Rezistenca në forcë	kg		UNI EN ISO 13934-1
Rezistenca në tërheqje			UNIENISO13934-1
Trajtimet	**Kundra rrudhosjes, kundra njollave vajore ,e papershkrueshme nga uji UNI EN ISO12945-2**		
	Trajtim kundra pushëzimit dhe krijimit të kokrrizave (nearfishing- antipilling) UNI EN ISO12945-2		
QENDRUESHMERIA E NGJYRES	**Njesia e matjes**	**Vlera dhe Toleranca**	**Metoda e proves**
Degradimi ne drite artificiale		4-5	UNI EN ISO 105-B02
Djersa bazike		Degradimi 4-5	UNI EN ISO 105-E04
Djersa alkaline / acide		Degradimi 4-5	UNI EN ISO 105-E04
Larje e thate		4-5	UNI EN ISO 105-D01
Nga uji		4-5	UNI EN ISO 105-E01
Ferkimi në të thatë		4-5	UNI EN ISO 105-X12
Ferkimi në të njomë		4-5	UNI EN ISO 105-X12
Nga pikat e uji		4-5	UNI EN ISO 105-E07
Me hekurosje		4	UNI EN ISO 105-X11

UNIFORMA CEREMONIALE

PANTALLONA

UNIFORMA CEREMONIALE E TRUPROJES SË NDERIT: PANTALLONAT

Pantallonat Ceremoniale Verore			
Ngjyra	**E Kuqe pantone tpx 18-863**		
Karakteristikat Fiziko-Mekanike	**Njesia e matjes**	**Vlera dhe toleranca**	**Standardi**
Emri i Tekstilit			Panno 1/96 1/96
Thurja			Tela uni 8099
Përbërja	%	70% lesh dhe 30% poliester	
Gjeresia e Tekstilit	cm	148/150	
Pesha për mtl	gr	240/250	EN 12127 - EN 29073/1
Pesha për mtq	gr	160/170	EN 12127 - EN 29073/1
Dendësia e fijeve në thurjen në horizontal (bazë) për cm	copë	16	UNI EN 1049/2
Titulli i Fillit			1/9600
Rezistenca në forcë	kg		UNI EN ISO 13934-1
Rezistenca në tërheqje	%		UNI EN ISO 13934-1
Dendësia e fijeve në thurjen në vertical (ind) për cm	copë	12/13	UNI EN 1049/2
Titulli i Fillit			1/9600 UNI 9275 - ISO 7211/5
Njëtrajtshmëris e dimensionit të fillit të leshit			UNI 5423
Rezistenca në forcë	kg		UNI EN ISO 13934-1
Rezistenca në tërheqje			UNIENISO13934-1
Trajtimet	**Kundra rrudhosjes, kundra njollave vajore ,e papershkrueshme nga uji UNI EN ISO12945-2**		
	Trajtim kundra pushëzimit dhe krijimit të kokrrizave (nearfishing- antipilling) UNI EN ISO12945-2		
QENDRUESHMERIA E NGJYRES	**Njesia e matjes**	**Vlera dhe Toleranca**	**Metoda e proves**
Degradimi ne drite artificiale		4-5	UNI EN ISO 105-B02
Djersa bazike		Degradimi 4-5	UNI EN ISO 105-E04
Djersa alkaline / acide		Degradimi 4-5	UNI EN ISO 105-E04
Larje e thate		4-5	UNI EN ISO 105-D01
Me uje		4-5	UNI EN ISO 105-E01
Ferkimi në të thatë		4-5	UNI EN ISO 105-X12
Ferkimi në të njomë		4-5	UNI EN ISO 105-X12
Me sperkatje uji		4-5	UNI EN ISO 105-E07
Me hekurosje		4	UNI EN ISO 105-X11

Përshkrim Model Pantallonat Ceremoniale Dimërore

Pantallonat të përbëhen prej:
Dy pjesësh të përparme pa xhepa dhe pa pensa, me bel të lartë prej një copë të vetme.
Dy pjesësh të prapme me xhep me fileto në krahun e djathtë, 1 fashetë qendrore dhe pjesa e belit e hapur në qendër të pantallonit në pjesën e prapme.
Pjesa fundore e prapme të jetë e përbërë prej pjesës së pulpës me qepje në qendër të gjurit në pjesën e prapme.
Pjesët e kofshëve të jenë të përbëra prej një kthine të sheshtë të mbyllur dhe të futura në pjesën e poshtme.
Në anësore të bashkohen nga qepja dhe nga një përforcim prej 6 mm.

Të mos ketë xhepa në anësore.
Beli i lartë rreth 8 cm nga brenda paraqet një forcim SILEAS i bardhë, 6 kopsa për llastikun. Në pjesën e prapme të ketë dy pensa të qepura rreth 13 cm tek të dyja pjesët.
Xhepi i pasëm me fileto të zezë të jetë rreth 13 cm dhe largohet rreth 14 cm nga pjesa e sipërme e pantallonave.
Fasheta simetrike dhe me bordurë të kuqe të jetë e larguar rreth 5,5 cm në pjesën e sipërme të belit dhe të jetë e pozicionuar në qendër të pjesës së prapme të pantallonave.
Pjesa e brendshme e përparme të ketë një përforcim RAYON i bardhë deri tek gjuri duke e përjashtuar atë.

Dizenjoja e pjesës së përparme të pantallonave

Pantallonat të paraqesin tek të dyja pjesët e përparme një motiv luleje me tre rrathë të mbyllur në një romb me tre cepa me borde në formë rrethi.

Dimensionet:
Boshti i brendshëm dopio të jetë me një gjatësi 26 cm dhe të përfundojë me tre rrathë DALLAE me diametër 3 cm dhe të larguar nga cepi i rombit rreth 3 cm.
Cepat e rombit për të tri anësoret të përfundojnë drejt pjesës së jashtme me një dizenjo prej rrethi me diametër 1 cm.
Rreth 20 cm nga beli (pjesa e sipërme) të nisi cepi i ketërt, nga këmba e lules që ndahet nga tubi dysh (6 mm).
Në pjesën anësore të jashtme të këmbëve të pantallonave, në mesin e tyre dhe në gjithë gjatësinë, është një shirit në ngjyrë të zezë me gjerësi 4cm +10%.
Pantallonat të përfundojnë me një bordurë të zezë me copë SILESIAS dhe me një hapje anësore nga ana e jashtme rreth 8 cm të bashkuar nga një shirit VELCRO rreth 2 cm.
Tek pjesa e fundit të aplikohet një llastik i zi me dimensione 3 cm H dhe 26 cm L.
Për oficerët kordoni është ngjyrë e verdhë, për n/oficerët dhe ushtarët kordoni është ngjyrë e zezë.

ARTIKUJ TË TJERË

KËPUCË GJYSMA BURRASH

UNIFORMA CEREMONIALE E ORKESTRËS FRYMORE: KEPUCË GJYSMA BURRASH

LEKURA E SIPERME:	
Materiali i siperm:	Lëkure e plotë lope. Kromi 6 është kategorikisht i ndaluar. Pa AZO (shkakton kancer).
Ngjyra:	e zeze
Thithja e ujit:	max. 30%
Forca e shqyerjes e materialit të sipërm	≥ 120 N EN ISO 20344 – 6.3
Forca e elasticitetit të materialit të sipërm	≥ 15 N/mm^2 EN ISO 20345 – 56.4
pH (vetëm për lëkurën e sipërme)	≥ 3.2 EN ISO 20344 – 6.9
Thithja e ujit:	Max 30% në 60 minuta EN ISO 20344:2004; 6.13
Penetrimi i ujit (rroba absorbuese):	Max. 2 gram në 60 minuta EN ISO 20344:2004; 6.13
Depërtueshmëria e avullimit të ujit (frymëmarrja)	0.8 mg / (cm2 h) (minimum) EN ISO 20344:2004; 6.6
Fleksibiliteti	Asnjë deformim në 50000 cikle (minimum) EN ISO 20344:2004; 6.5
VESHJA E BRENDSHME:	
Karakteristika:	Frymëmarrëse, thith djersën, anti – bakteriale
Forca e shqyerjes së veshjes së brendshme	≥ 30 N EN ISO 20345 – 5.5.1
Rezistenca ndaj konsumimit	>25.600 cikle të thata EN ISO 20345 – 5.5.2 >12.800 cikle të lagura EN ISO 20345 – 5.5.2

SHOLLA:	
Peshë	Sa më të lehtë
Anti – statike (A) :	Siguron minimizimin elektrosatik krijuar për të shmangur riskun e dridhjeve nga korrenti
Takë absorbuese energjie (E) :	Siguron komfort dhe qëndrueshmëri gjatë ecjes, vrapimit etj, duke absorbuar forcën e tepërt të trupit.
Rezistenca ndaj hidrolizës :.	Siguron qëndrueshmëri në shollë kundra lagështirës, kohës së ftohtë dhe të nxehtë
KARAKTERISTIKAT:	
Komforti:	Këpuca duhet të jetë e rehatshme.
Përshtatshmëria:	Këpuca është e përshtatshme për ecje për një kohë të gjatë, për ambjente zyrash, ofron rehati dhe fleksibilitet.
Amortizimi i goditjeve:	Sholla e këpucës duhet të jetë efektive në amortizimin e goditjeve në mënyrë që të minimizoje dëmtimet në kyce dhe pjesën e poshtme të këmbës.
Përthyeshmëria:	Këpuca duhet të jetë elastike dhe fleksibël.
Siguria:	Duhet të lidhet mirë që të mbajë këmbën në vend. Nëse këmba rrëshqet brenda këpucës mund të shkaktohet ënjtje.
Ajrosja:	Këpuca duhet të lejojë këmbën të ajroset. Këmba mund të prodhojë sasi të konsiderueshme djerse, duke shkaktuar kështu ënjtje ngaqë lëkura bëhet e butë dhe mund të marrë infeksione. Prandaj cilësia e materialeve të përdorura dhe cilësia e tyre për t'u ajrosur është shumë e rëndësishme.
Rrëshqitja:	Këpuca duhet të mos rrëshqasë.
Mbështetja:	Këpuca gjithashtu duhet të mbrojë këmbën nga objekte të mprehta, acidet, vajrat, antistatike, absorvues djerse.

ARTIKUJ TË TJERË

ÇORAPE TË SHKURTRA

ARTIKUJ TE TJERE: ÇORAPE	
PËRBËRJA E MATERIALIT:	
Ngjyra	E zeze
90 %	Pambuk
7 %	Poliamid
3 %	Elastan

ARTIKUJ TË TJERË

DOREZAT CEREMONIALE PAMBUKU

ARTIKUJ TË TJERË: DOREZA CEREMONIALE PAMBUKU	
Përbërja	Dorezat të jenë të përbëra nga fibra pambuku, të punuara me fill dysh. Përbërja pambuk Tip "America I".
Modeli	Dorezat si model duhet t'i korrespondojnë modelit ushtarak dhe të përbëhen secila nga : • Pjesa e kyçit të dorës. • Pjesa kryesore (shpina e dorës dhe pëllëmba). • Pesë gishtërinjtë;. Gishti i madh të lidhet me trupin e dorezës nëpërmjet dy të qepurave paralele të distancuara njëra nga tjetra 2 mm. Gishtërinjtë duhet të jenë në proporcion; meqenëse dorezat duhet të jetë komode dhe estetike, majat e tyre duhet të jenë të rrumbullakosura. Ekstremiteti i lirë i kyçit të jetë i përthyer nga brenda dorezës. Kthimi të jetë i lartë rreth 20 mm dhe të ndalet nëpërmjet qepjes me makinë i shoqëruar nga një fill i fortë i kthyer në tre herë për lakun dhe prej mëndafshi natyral i kthyer dy herë për gjilpërën e qëndisjes. Nga ana e pëllëmbës, doreza të shfaqë duke nisur nga bordura e kyçit, një të çarë me një gjatësi prej 75mm, anët e të cilës janë të përthyera dhe të forcuara me një pjesë shiriti të bardhë pambuku, të lartë rreth 15 mm. 40 mm nga bordura e pulsit, e çara të fillojë të mbyllet me një kopsë të bardhë me përbërje sintetike, me mbështetje, me kokë rrumbullake me diametër 12 mm dhe që përputhet me syçkën. Në vend të llojit të kopsës së përshkruar me sipër mund të përdoret një kopsë e bardhë me përbërje sintetike, me katër vrima, me diametër të njëjtë. Syçka të jetë e forcuar nga brenda dorezës me një pjesë të vogël nga shiriti i bardhë i përshkruar me sipër me material , të bërë dysh (dopio). Pikat e mbërthimit të kopsës të jenë edhe ato të forcuara nga brenda me po ato pjesë nga shiriti i përshkruar më lart. Mbi shpinore, doreza të shfaqë tre qepje me reliev, divergjentë midis tyre, të cilat të fillojnë rreth 75 mm nga bordura e kyçit dhe të arrijnë deri aty ku fillon hapja e gishtërinjve; të tilla qepje të realizohen me pikë të gërshetuara, nëpërmjet një filli pambuku të bardhë, të cilësisë së lartë, të bërë tresh.
Qepja	Qepjet e tjera të dorezës duhet të kryhen me një fill të fortë pambuku të bërë tresh. Të gjitha qepjet duhet të rezultojnë rezistente dhe t'i korrespondojnë për nga lloji dhe rregullsia modelit ushtarak. Po ashtu, ato duhet të kenë fije që perfundojne te prera mirë: të bëhet përjashtim për tre qepjet me reliev, ekstremitetet e të cilave, drejt pulsit, duhet të jenë të lira, vetëm nëse dalin nga coha, në pjesen e brendshme të dorezës, me një gjatësi prej 10-20 mm. Dorezat duhet të kthehen mire nga ana e brendshme. Masat nga 6 – 9.
Ngjyra	E Bardhë

AKSESORËT

PËR UNIFORMËN E TRUPROJES SË NDERIT DHE OKESTRËN FRYMORE

AKSESORËT

PËR KAPELEN ME STREHË

UNIFORMA CEREMONIALE E TRUPROJES SË NDERIT DHE OKESTRËS FRYMORE: AKSESORËT E KAPELES ME STREHË	
EMBLEMA E KAPELES :	
Materiali:	Tunxh (aliazh zinku dhe bakri). Materiali të tjajtohet me mbrojtje anti oksiduese.
Ngjyra:	E verdhë, me shkëlqim mat
Trashësia:	2 mm
Përmasat	6cm X 5 cm
Montimi	Me 2 vida me filetim
Prodhimi	Stampim me derdhje në 3D (ose stampim në të ftohtë)
Modeli	Shqiponja dykrenare e stilizuar dhe mbi shqiponjën është vendosur simboli i kapeles së heroit tonë kombëtar Skënderbeut.
KORDONËT PËR KAPELET E OFICERËVE	
Materiali veshja e jashtme	100% metalike (Bronz)
Materiali në brendësi	100% pambuk
Përmasat	Kordonët metalik diametri 16mm
Ngjyra:	E Verdhë.
Qëndrushmëria e ngjyrës:	Shiritat duhet të kenë qëndrueshmëri maksimale me trajtim anti oksidues.
Thurja:	Thurje tubolare tresh me shkëlqim mesatar metalik me ngjyrë të verdhë.
KORDONËT PËR KAPELET E N/OFICERËVE DHE USHTARËVE:	
Materiali veshja e jashtme	100% poliestër
Materiali në brendësi	100% pambuk
Përmasat	Kordonët poliestër diametri 16mm
Ngjyra:	E Kuqe.
Qëndrushmëria e ngjyrës:	Shiritat duhet të kenë qëndrueshmëri maksimale me trajtim anti oksidues.
Thurja:	Thurje tubolare tresh me ngjyrë të kuqe.

AKSESORËT

PËR XHAKETËN CEREMONIALE

UNIFORMA CEREMONIALE E TRUPROJES SË NDERIT DHE OKESTRËS FRYMORE: AKSESORËT E XHAKETËS CEREMONIALE

KORDONAT DEKORATIVË TË XHAKETËS SË OFICERËVE:	
Materiali	100% Poliestër
Ngjyra:	E Verdhë
Trashësia:	6 mm
KORDONAT DEKORATIVË TË XHAKETËS SË N/OFICERËVE DHE USHTARËVE	
Materiali	100% Poliestër
Ngjyra:	E Zezë
Trashësia:	6 mm
SHENJA E KRAHUT TË MAJTË (SIMBOLI KOMBËTAR)	
Përmasat:	60mm X 40mm
Modeli	Emblema duhet të ketë një sfond të kuq me ngjyrën e flamurit Shqiptar ku në të do të qëndiset me fill të zi shqiponja jonë kombëtare. Në pjesën e sipërme të emblemës me një dimension 60 x 12 mm do të qëndiset një sfond i zi ku në qendër të tij do të qëndiset me gërma të arta fjala "Albania". Në të gjithë perimetrin e emblemës do të bëhet një bordurë 1.5mm me fill të artë i cili do të rrethojë të gjithë emblemën. Shenja e krahut bashkohet me mëngën e xhaketës me ngjitje me material valkrof.
Materiali i Fijes	Fijet do të jenë poliestër me ndriçim sipas ngjyrave të përmendura më sipër.
SHENJA E KRAHUT TË DJATHTË E TRUPROJES SË NDERIT (EMBLEMA E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FA).	
Përmasat	60mm X 76mm
Modeli	Emblema ka formën e një shqyte me tre ngjyra, bojë qelli, të gjelbër dhe blu ku në të do të qëndisen simbolet e tre forcave kryesore, Forcës Ajrore – krahët, Forcës Tokësore – dy pushkë të kryqëzuara dhe Forcës Detare – spiranca, që simbolizon forcën e bashkuar. Shqyta është e rrethuar me bordurë 1.5mm me fill të artë në të gjithë perimetrin e saj. Shenja e krahut bashkohet me mëngën e xhaketës me ngjitje me material valkrof.
Kodi i ngjyrave	Bojë qelli - R:64 G:200 B:244; Jeshile - R:0 G:166 B:81; Blu - R:12 G:77 B:162; E Verdhë - R:210 G:170 B:65;
SHENJA E KRAHUT TË DJATHTË E OKESTRËS FRYMORE (SYMBOLI NDËRKOMBËTAR I LIRËS):	
Përmasat	Ne formë rrethi me diameter 50mm +10%
Modeli:	Emblema ka formën e një rrethi me ngjyrë të zezë ku në mes të saj është qëndisur me fill të artë simboli i lirës.
Materiali	I njëjtë me atë të xhaketës. Shenja e krahut bashkohet me mëngën e xhaketës me ngjitje me material valkrof.

GRADAT E JAKËS:	
Përmasat:	35mm X 80mm
Modeli	Gradat të ketë një sfond të zi ku do të qëndisen me fill i gradat sipas ngjyrave përkatëse (të verdhë ose të bardhë). Në të gjithë perimetrin e gradës do të bëhet një bordurë 1.5mm me fill të artë i cili do të rrethojë të gjithë gradën. Gradat do të ngjiten në jakë me material valkrof.
Ngjyra::	E Zezë.
KORDONAT DEKORATIVË TË XHAKETËS:	
Materiali veshja e jashtme	100% Poliestër
Thurja:	Tubolare me diametër: 8 mm
Ngjyra:	E Verdhë
Përmasat :	Gjatësia totale të jetë 1.63 m, në fund të kordonit të kemi pjesë metalike me dimensione 7.5 cm .
Modeli:	Thurja e tij të bëhet me 3 shirita tubolarë të cilat të kryqëzohen me njëri - tjetrin, në pjesën e sipërme majat qepen dhe në pjesën fundore të vendoset pjesa metalike. Gjatësia totale të jetë 1.63 m, në fund të kordonit të kemi pjesë metalike me dimensione 7.5 cm.
KOPSAT E XHAKETËS	
Forma:	Ovale
Gjatësia:	50mm
Ngjyra:	E Zezë lucido
Diametri:	Max 18mm
Përbërja:	Poliuretan me ngjyrim në paste
Modeli:	Në qendër të ketë dy vrima me diametër 5 mm dhe të baraslarguara nga pjesa anësore.

AKSESORËT

RRIP CEREMONIAL OFICERËT

ARTIKUJ TË TJERË: RRIP CEREMONIAL PËR OFICERËT

Rrip Ceremonial për Oficerët përbëhet nga :
• Pjesa e përparme. • Pjesa e brendshme. • Pjesa e mbrapme. • Ylyqet. • T ogëza.

Karakteristikat Fiziko-Mekanike	Njesia e matjes	Standardi
Pjesa e përparme		
Emri i Tekstilit		CANOTILIA
Thurja		Në diagonal
Përbërja		Fije poliester veshur me argjend dhe e galvanizuar me ar
Gjerësia	mm	60
Pjesa e brendshme		
Përbërja		Karton gjysmë i plastifikuar
Trashësia	mm	1 mm
Pjesa e mbrapme		
Përbërja	%	Tekstil 100% viskoze.
Pesha	gr/m2.	140
Ngjyra		E Zezë
Ylyqet:		
Përbërja		I njëjti material si rrip
Gjerësia	mm	20 mm
Sasia	copë	3
Togëza		
Përbërja		Bronx, të gjitha pjesët metalike të rripit do të galvanizohen me ar 18 karat mat në menyrë që të pengohet procesi i oksidimit.
Forma		Elipsiojdale me diametër maksimal 65 mm dhe diametër minimal 45 mm.
Ngjyra		E Verdhë

Përshkrim Model Rrip Ceremonial për Oficerët

Pjesa e përparme e rripit përbëhet nga:
Një tekstil në formë shiriti me gjerësi fikse 60 mm dhe gjatësi relative sipas kërkesës nga 1150 mm deri në 1400 mm. Përbërja e tekstilit "CANOTILIA" të jetë fije poliester veshur me argjend dhe e galvanizuar me ar. Ato të thuren në diagonal. Në dy ekstremet e rripit kemi një bord prej 7 mm.

Pjesa e brendshme e rripit përbëhen prej:
Nga një karton gjysmë i plastifikuar me trashësi (spesor) 1 mm elastik dhe i fortë.

Pjesa e mbrapme e rripit përbëhet nga:
Tekstil i zi 100% viskoze. Pesha 140 gr/m2.

Te tre pjesët të bashkohen ndërmjet tyre nëpërmjet procesit të qepjes me makine. Njëra pjesë ekstreme e rripit të qepet me unazën gjysëm eklipsi e lëvizshme, kurse pjesa tjetër ekstreme e rripit të montohet me gjysëm unazën në formë eklipsi e cila të jetë e ngjitur me togzën.

Ylyqet përbëhet nga:.
I njëjti material si rripi. Gjithsej të jenë 3 ylyqe Ato të jenë në formë unaze me gjerësi 20 mm dhe të shërbejnë për të fiksuar pozicionin e rripit dhe ndryshimin e gjatësisë së tij sipas kërkesës.

Togëza përbëhet nga:.
Togëza në formë elipsi. Diametri maksimal është 65 mm dhe diametri minimal është 45 mm. Në qëndër të saj është gdhëndur shqiponja dykrenare në 3D. Mbi shqiponjën është vendosur simboli i kapeles së heroit tonë kombëtar Skenderbeut e rrethuar nga një unazë perimetrale ovale dhe fusha mes shqiponjës dhe unazës perimetrale është me mini basoreliev mat.

Në krahun e majtë të saj është e ngjitur gjysëm unaza që lidhet me rripin, ndërsa nga ana e pasme e togzës është i ngjitur një vesh në formën e gërmës "L" ku fiksohet gjysëm unaza e krahut të djathtë.

Gjithashtu kemi edhe një unazë në formë elipsi ku diametri i madh maksimal është 65 mm dhe diametri minimal është 15 mm. Ajo përbëhet nga material bronxi në formë teli me diameter 2 mm. Në njërën pjesë të saj është montuar rripi dhe në pjesën e brendshme të saj futet pjesa tjetër e rripit. Me anë të kësaj unaze zmadhohet dhe zvogëlohet gjatësia e rripit. Në pjesën ekstreme të rripit ku montohet gjysëm unaza e lëvizshme do të qepet një pjesë rripi me gjatësi 170 mm e cila qëndron nën togzën dhe tregon vazhdimësine e rripit me pjesën tjetër.

Të gjitha pjesët metalike të rripit do të galvanizohen me ar 18 karat mat në menyrë që të pengohet procesi i oksidimit.

Mënyra e prodhimit të togzës : fuzion me derdhje të metalit me stampë.

Drejtusi i Lartë i Orkestrës Frymore do e ketë rripin ngjyrë ari.

AKSESORËT

RRIP CEREMONIAL N/OFICERËT DHE USHTARËT

ARTIKUJ TË TJERË: RRIP CEREMONIAL PËR N/OFICERËT DHE USHTARËT	
RRIPI:	
Materiali	Lëkure boks viçi
Ngjyra	Kafe e errët mat.
Trashësia	3.5-4mm
Gjërësia	60mm
Gjatëia	Mënyra e lidhjes së togzëz me rripin do të jetë e ngjashme me atë të rripit ceremonial. Gjatësia e rripit do të jetë e ndryshueshme nëpërmjet togzës sipas gjerësisë perimetrale të personit që e posedon atë. Mënyra e lidhjes së togzëz me rripin do të jetë e ngjashme me atë të rripit ceremonial. Gjatësia e rripit do të jetë e ndryshueshme nëpërmjet togzës sipas gjerësisë perimetrale të personit që e posedon atë.
Togëza:	
Materiali	Bronxi Të gjitha pjesët metalike të rripit do të galvanizohen me ar 18 karat mat në menyrë që të pengohet procesi i oksidimit.
Ngjyra	E Verdhë
Përshkrim Model Rrip Ceremonial për N/Oficerët dhe Ushtarët	
Togëza ka formë elipsi. Diametri maksimal është 65 mm dhe diametri minimal është 45 mm. Në qendër të saj është gdhendur shqiponja dykrenare në 3 D. Mbi shqiponjën është vendosur simboli i kapeles së heroit tonë kombëtar Skënderbeut e rrethuar nga një unazë perimetrale ovale dhe fusha mes shqiponjës dhe unazës perimetrale është me mini basoreliev opake. Mënyra e prodhimit të togzës : fuzion me derdhje të metalit me stampë. Në krahun e majtë të saj është e ngjitur gjysëm unaza që lidhet me rripin, kurse nga ana e mbrapme e togzës është i ngjitur një vesh në formën e gërmës "L" ku fiksohet gjysëm unaza e krahut të djathtë. Njëra pjesë ekstreme e rripit të qepet me unazën gjysëm eklipsi e lëvizshme, kurse pjesa tjetër ekstreme e rripit të montohet me gjysëm unazën në formë eklipsi e cila të jetë e ngjitur me togzën. Gjithashtu kemi edhe një unazë në formë elipsi ku diametri i madh maksimal është 65 mm dhe diametri minimal është 15 mm. Ajo përbëhet nga material bronxi në formë teli me diametër 2 mm. Në njërën pjesë të saj është montuar rripi dhe në pjesën e brendshme të saj futet pjesa tjetër e rripit. Me anë të kësaj unaze zmadhohet dhe zvogëlohet gjatësia e rripit .Në pjesën ekstreme të rripit ku montohet gjysëm unaza e lëvizshme do të qepet një pjesë rripi me gjatësi 170 mm e cila qëndron nën togzën dhe tregon vazhdimësinë e rripit me pjesën tjetër.	

AKSESORËT

PËR PANTALLONAT CEREMONIALE

UNIFORMA CEREMONIALE E TRUPROJES SË NDERIT DHE OKESTRËS FRYMORE: AKSESORËT E PANTALLONAVE CEREMONIALE	
KORDONAT DEKORATIVË TË PANTALLONAVE TË OFICERËVE:	
Materiali	100% Poliestër
Ngjyra:	E Verdhë
Trashësia:	6 mm
KORDONAT DEKORATIVË TË PANTALLONAVE TË N/OFICERËVE DHE USHTARËVE	
Materiali	100% Poliestër
Ngjyra:	E Zezë
Trashësia:	6 mm
RRIPAT QË MBAJNË PANTALLONAT (TIRANDA)	
Përmasat:	**Rripat:** • Gjatësia në pjesën e prapme 10 cm dhe në pjesën e përparme rreth 90 cm. • Gjerësia 2,5 cm . **Kordura:** • Gjatësia 9,5 cm. • Gjerësia 1cm.
Ngjyra:	**Rripat**: E Zezë **Kordura**:E Zezë
Modeli:	Rripat të përbehen nga tre pjesë të bashkuara nga forcimi i lëkurës. Dy pjesët e përparme të përfundojnë me një përforcim në lëkurë dhe thumba në kordurë për t'u aplikuar në rripin e pantallonave. Gjatësia të rregullohet nga një togëz e vendosur dhe me dimension prej 3 cm. Pjesa e prapme të përfundojë me një përforcim në lëkurë dhe 2 fiksues në kordure për t'u aplikuar në rripin e pantallonave në pjesën qendrore.

AKSESORËT

SHPATA CEREMONIALE

UNIFORMA CEREMONIALE E TRUPROJES SË NDERIT DHE OKESTRËS FRYMORE: SHPATA CEREMONIALE	
SHPATA CEREMONIALE PËRBËHET NGA KËTO ELEMENTË: • Lama. • Doreza. • Këllëfi. • Rripi Mbajtës i Shpatës. • Lordoni Zbukurues.	
SHPATA	
Materiali:	Çelik inoks që nuk ndryshket, lehtësisht e harkuar. Duhet të jetë e kompletuar me një këllëf që mban shpatën
Gjatësia totale e shpatës	100cm-110cm.
Gjerësia e shpatës:	2cm +.10%.
TEHU I SHPATËS (LAMA)	
Materiali:	Çelik inoks dhe i dekoruar në të dyja anët me simbolin kombëtar të dukshëm. Me majë të rrumbullakët jo të mprehtë.
Gjatësia:	95cm-100cm.
Doreza e Shpatës:	Të jetë me mbulojë metalike në pjesën e kapjes së dorezës.
KËLLËFI	
Materiali:	Çelik inoks.
Gjatësia:	Gjatësia 96 cm
Rripi që mban shpatën:	Me ngjyrë të verdhë me një kordon të hollë të kuq në mes.
KORDONI ZBUKURUES.	
Materiali:	Poliestër
Ngjyra:	E Verdhë

AKSESORËT

ÇANTA PËR MBAJTJEN E KOSTUMIT

UNIFORMA CEREMONIALE E TRUPROJES SË NDERIT DHE OKESTRËS FRYMORE: ÇANTA PËR MBAJTJEN E KOSTUMIT	
Materiali:	Poliestër
Pesha nëgr/m2:	80-90gr/m2
Përmasat:	120x60 cm
Ngjyra:	E Zezë
MODELI	
Në mes të jetë vendosur një zinxhir i hollë 4 mm spiral plastik me gjatësi 120 cm. Në të dy pjesët e çantës me dimensione 60 cm të vendosen dy doreza. Dorezat të jenë nga i njëjti material me çantën të përforcuara me qëllim që mbulesa e kostumit gjatë palosjes të bëhet në formën e çantës. Qepja e të gjitha pjesëve dhe zinxhiri të jetë bërë me makinë.	

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 36
Datë: 2022/03/09 11:31:24
e3b69170-47ac-4193-9cfc-f855218db206

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 5520 lekë